

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar pas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Shoqëria aksionare e Telekomunikacije Republike Srpske, Banja Luka me seli të regjistruar në rr. Vuka Karaxhiq Nr. 2, Banja Luka, Republika Srpska, Bosnje dhe Hercegovinë, në seancën e mbajtur më 25.01. 2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi që i referohet fitimit të kontrollit të vetëm nga Shoqëria aksionare e Telekomunikacije Republike Srpske, Banja Luka me seli të regjistruar në rr. Vuka Karaxhiq Nr. 2, Banja Luka, Republika Srpska, Bosnje dhe Hercegovinë mbi shoqërinë TRION TEL SHPK Banja Luka, me seli në ul. Vidovdanska numër 8, Banja Luka, Republika Srpska, Bosnje dhe Hercegovinë, përmes shitblerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës më 29.12.2022, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) është dorëzuar një njoftim i përqendrimit nga Shoqëria aksionare e Telekomunikacije Republike Srpske, Banja Luka me seli të regjistruar në rr. Vuka Karaxhiq Nr. 2, Banja Luka, Republika Srpska, Bosnje dhe Hercegovinë, me të cilin Shoqëria aksionare e Telekomunikacije Republike Srpske, Banja Luka do të fitoj kontroll mbi shoqërinë TRION TEL SHPK Banja Luka, me seli në ul. Vidovdanska numër 8, Banja Luka, Republika Srpska, Bosnje dhe Hercegovinë, përmes shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Shoqëria aksionare e Telekomunikacije Republike Srpske, Banja Luka- (MTEL) është një operator i regjistruar për shërbimet dhe rrjetet e komunikimit elektronik bazuar në lejet nga Agjencia Rregullatore për Komunikimet e Bosnjës dhe Hercegovinës në territorin e Bosnje dhe Hercegovinës.

Subjekt i lidhur i Parashtruesit të njoftimit në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është:

-Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNP Shkup, me seli të regjistruar në rrugën „Maksim Gorki”, 11/1 kati i 3-të, Shkup , Republika e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë e telekomunikacionit me tela, gjegjësisht për ofrimin e shërbimeve satelitore dhe ri-emetimin e programeve dhe shërbimeve televizive („ MTEL DOOEL“).

TRION TEL SHPK Banja Luka është një operator që posedon licenca të lëshuara nga Agjencia Rregullatore e Komunikimeve të Bosnjës dhe Hercegovinës për kryerjen e aktiviteteve të një operatori për rrjetet publike të komunikimit elektronik, lejet për të kryer aktivitetet e një ofruesi të qasjes në internet dhe lejet për të përdorur numra individualë jo gjeografikë/të shkurtër.

TRION TEL shpk Banja Luka nuk ka persona juridikë të lidhur dhe as nuk ka krijuar të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски